

APLIKACION I PUNËS SË ËNDËRRAVE nga Dormeo

Marrëveshje

STUDIO MODERNA GROUP¹



*** Kjo marrëveshje ka për qëllim të testojë përputhshmërinë me Rregulloren (EU) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 27 prill 2016 mbi mbrojtjen e personave në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla, si dhe shfuqizimin e Direktivës 95/46 / EC (Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave)

*** Legjislacioni i kompanive të krijuara jashtë BE mund të jenë të ndryshme, megjithatë në shumicë të njejtat parime zbatohen.

¹ Studio Moderna Holding B.V. dhe degët e saj

*** Kjo marrëveshje nuk është menduar për qëllime të pajtueshmërisë me fusha të tjera ligjore.¹

Përgatitur nga:	Katja Resnik, Data Protection Officer
Business Owner:	Sanela Karabegović Sinanović, Internet Project Manager
Data:	February 18, 2019

Përmbajtja

Përmbledhja e të dhënave personale.....	2
Regjistrimi i aktiviteteve	Error! Bookmark not defined.
Kufizimi /Fshirja e të dhënave personale	Error! Bookmark not defined.
Procesi i të dhënave personale.....	Error! Bookmark not defined.
Modeli i termeve dhe kushteve të përgjithshme	Error! Bookmark not defined.
APLIKACIONI I PUNËS SË ËNDËRRAVE nga Dormeo	Error! Bookmark not defined.
Termet dhe kushtet e përgjithshme.....	Error! Bookmark not defined.
Organizatori	6
Qëllimi i konkursit	Error! Bookmark not defined.
Procesi i konkursit.....	Error! Bookmark not defined.
Kush mund të marrë pjesë?	Error! Bookmark not defined.
Si të merrni pjesë?	Error! Bookmark not defined.
Përzgjedhja e fituesit fatlum!.....	Error! Bookmark not defined.
Komisioni organizues	Error! Bookmark not defined.
Tatimet.....	Error! Bookmark not defined.
Procesimi i të dhënave personale	Error! Bookmark not defined.
Përgjegjësia e organizatorit	Error! Bookmark not defined.
Të tjera	Error! Bookmark not defined.

Mbledhja e të Dhënave Personale

Kompanitë SM dëshirojnë të organizojnë konkursin, ku Fituesi do të zgjidhet për të punuar për një ditë si "testues gjumi". Pjesëmarrësi duhet të ndajë të dhëna të caktuara personale me kompaninë SM nëse ai / ajo dëshiron të marrë pjesë në konkurs, përkatësisht këto të dhëna:

- Gjininë;
- Emri i plotë (emri, mbiemri);
- Qyteti;
- Mosha,
- E-mail
- Përgjigjet në lidhje me zakonet e gjumit.

DREAM JOB APPLICATION

by Dormeo®

Become Dormeo Sleeper and
Earn 100€ for 8h of Sleep

APPLICATION FORM:



☐ Female ☐ Male

FULL NAME: *

CITY: *

AGE: *

ENTER E-MAIL: *

Figura 1: Të dhëna Personale të kërkuara në rast pjesëmarrje

PERSONAL SLEEP RECORD?

1 hour **36** > 72 hours

HIT SNOOZE BUTTON RECORD?

1 **10** > 19

STRANGEST PLACE YOU'VE FALLEN ASLEEP?

DID YOU SLEEP DURING CLASS?

☐ Da ☐ Ne

CAN YOU SLEEP IN A NOISE ENVIRONMENT?

☐ Da ☐ Ne

HIGH-LOW PILLOW?

High **Medium** Low

HARD-MEDIUM-SOFT MATTRESS?

Hard **Medium** Soft

DO YOU SLEEPWALK?

☐ Da ☐ Ne

DESIRED SALARY PER HOUR OF SLEEP?

10 € **60** 110 €

Terms and conditions, terms and conditions [terms and conditions](#) terms and conditions text.

☐ By subscribing I agree with [E-newsletter terms](#) and I am aware I can withdraw my consent at any time.

Apply Now!

Figura 2: Përgjigjet që pjesëmarrësi duhet t'i jap. Linku i parë në fund të formës duhet ti referohet termeve dhe kushteve gjenerale të këtij konkursi. Linku i dytë (pëlqimi) duhet të ketë një shpjegim të shkurtë se çka do të thotë, me një link shtesë të termeve të privatësisë së web-faqeve.

Kompanitë SM do të mbledhin vetëm të Dhënat Personale që nevojiten për organizimin e Konkursit:

- Emri, Mbiemri dhe E-mailin për komunikim me Pjesëmarrësin;
- Moshën, Gjininë, Qytetin për zgjedhjen e Fituesit

Të Dhënat Personale të mbledhura janë proporcionale me qëllimin.

Regjistrimet e aktiviteteve të procesit

Çdo kompani SM duhet të bëjë të mundur regjistrimin e procesverbalit i cili mund të gjendet **KËTU** dhe duhet të arkivohet **KËTU** (mund të arkivohet vetëm në gjuhën lokale).

Kufizimi / Fshirja e të dhënave personale

Të dhënat personale të grumbulluara gjatë Konkursit do të fshihen brenda një periudhe të caktuar pas Konkursit, me përjashtim të Fituesve (të dhënat e të cilëve do të përpunohen më tej në përputhje me kontratën e nënshkruar ndërmjet kompanisë SM dhe Fituesit) dhe atyre që kanë dhënë pëlqimin për komunikim personal të marketingut, të dhënat personale të të cilëve do të përpunohen në përputhje me politikën e privatësisë së kompanisë SM.

Procesi i të dhënave Personale

1. Pjesëmarrësi regjistrohet përmes formës në **gjumashat.com**;
2. Të Dhënat Personale do të procesohen në Magento dhe SilverPop (Databaza e aplikacionit të punës së ëndërrave) përgjatë procesit të Konkursit dhe për periudhë të pacaktuar pas (sipas definimit të Termeve & Kushteve Gjenerale);
3. Nëse pjesëmarrësi jep pëlqimin për komunikim të mëtutjeshëm, të dhënat Personale do të transferohen me tej në CA dhe SilverPop, në përputhje me të Dhënat Personale të tyre.

Modeli i Termeve dhe Kushteve Gjenerale

****Ky është një model i termeve dhe kushteve i Aplikacionit të Punës së Endërrave, i cili është përgatitur në bazë të udhëzimeve gjenerale. Sidoqoftë, është e rëndësishme të shqyrtohen termet dhe kushtet në përputhje me implementimin aktual dhe legjislacionin tuaj lokal.*

APLIKACIONI I PUNËS SË ËNDËRRAVE nga Dormeo

Termet dhe kushtet gjenerale

Organizatori

Organizatori i Konkursit të Punës së Ëndërrave ("Konkursit") është Studio Moderna Kosovë sh.p.k, Rruga UCK 258, 70086432 ("**Organizatori**").

Për të marrë pjesë në këtë Konkurs ju duhet të pajtoheni me Termet dhe Kushtet Gjenerale për pjesëmarrje ("Rregullat"). Pjesëmarrja në Konkurs nuk varet nga blerja e ndonjë produkti.

Këto rregulla do të jenë, përgjatë Konkursit, të publikuara online në dormeo-ks.com dhe/ose në profilin e FB, në dispozicion tek gjumashat.com. Në çdo kohë, Rregullat mund të kërkohen nga Organizuesi, duke parashtruar këtë kërkesë me info@dormeo-ks.com ose duke ju telefonuar në 038 244 644 91.

Qëllimi i Konkursit

Qëllimi i Konkursit është të përzgjedh 6 pjesëmarrës, të cilët për një ditë (8 orë) do të testojnë produktet e gjumit të zhvilluara dhe të shitura nën markën Dormeo®, si shkëmbim për pagesën në shumë 100 EUR.

Procesi i Konkursit

Konkursi do të mbahet nga 27.02.2019 në 13.02.2019 Aplikimi mund të bëhet përmes gjumashat.com. Konkursi mund të përfundojë në këtë datë, nga vendimi prej Komisionit Organizues. Nuk ka asnjë ankesë kundër këtij vendimi. Vendimi i Komisionit Organizues rreth të gjitha pyetjeve që lidhen me Konkursin ose tek përdorimi i Rregullave është përfundimtar dhe duhet të aplikohet tek të gjithë pjesëmarrësit.

Kush mund të marrë pjesë?

Kushdo që është mbi 18 vjet dhe është person fizik, me një qëndrim të përhershëm në KOSOVË, mund të marrë pjesë në këtë Konkurs ("Pjesëmarrës").

Punonjësit e organizatorit ose çdo individ tjetër i cili drejtpërdrejtë merr pjesë në organizimin e Konkursit dhe anëtarët e tyre të ngushtë të familjes (bashkëshorti ose partneri, prindërit, fëmijët) nuk mund të marrin pjesë në Konkurs.

Si të merrni pjesë?

Të gjithë individët, të cilët dëshirojnë për të marrë pjesë, mund ta bëjnë këtë duke plotësuar pyetësorin në gjumashat.com dhe duke u pajtuar me këto Rregulla. Të dhënat personale në vijim duhet të dorëzohen:

- Gjinia;
- Emri i plotë (emri dhe mbiemri);
- Moshë;
- E-mail.

Pjesëmarrësit, të cilët dëshirojnë të marrin pjesë duhet t'u përgjigjen gjithashtu pyetjeve të mëposhtme:

- Rekordi personal i gjumit;
- Rekordi i butonit Snooze;
- Vendi më i çuditshëm që ju keni flejt në gjumë ?;
- A keni fjetur në klasë ?;
- A mund të fleni në një mjedis me zhurmë ?;
- Jastëk të lartë ose të ulët ?;
- Dyshek i fortë i mesëm-i butë ?;
- A jeni person që ecni në gjumë ?;
- Paga e dëshiruar për orë të gjumit ?;

Zgjedhja e fituesit fatlum!

Brenda 1 ditësh pas përfundimit të Konkursit, Komisioni do të zgjedhë 6 fitues, të cilët do të nënshkruajnë një kontratë me Organizatorin për të punuar një ditë pune si testues gjumi.

Fituesi do të zgjidhet bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Përgjigjieve në pyetësor;

Organizatori dhe fituesi do të bien dakord për datën dhe kohën e kësaj dite pune. Shtrirja e aktiviteteve të fituesve do të jetë të flejnë sa më shumë që mundet gjatë kohës së punës dhe të paguhet për të.

Komisioni Organizues

Në rast se Komisioni ka dyshime për shkelje të rregullave, mund të kontaktojë pjesëmarrësin për të sqaruar situatën. Pjesëmarrësi duhet të deshmojë padyshim se ai është pajtuar me Rregullat. Në rast se ai nuk e vërteton këtë fakt ose nuk i përgjigjet thirrjes së Komisionit, Komisioni ka të drejtë të diskualifikojë menjëherë pjesëmarrësin, i cili pastaj humbet të drejtën për të marrë pjesë në konkurs.

Përpunimi i të Dhënave Personale

Të dhënat personale të mbledhura (siç janë përcaktuar më sipër) do të përdoren dhe përpunohen vetëm për qëllimet e Garës, përkatësisht:

- Shpallja e Fituesit në internet (në faqen e internetit, llogaritë e mediave sociale të Organizatorit etj.) - vetëm emri dhe mbiemri do të publikohen (jo të dhëna të tjera të paraqitura) dhe çdo njoftim tjetër publik i Fituesit emrin në lidhje me Garën;
- Fotot dhe rekordet e Fituesve, të cilat mund të merren pas shpalljes së Fituesve dhe gjatë kontratës së nënshkruar, që Organizatori mund të përdorë, në lidhje me promovimin e produkteve të testuara ose të markës tregtare ose të lidhura me Konkursin, pa ndonjë pagesë për Fituesit.

Të gjitha informatat, të dhënat personale dhe të tjera që pjesëmarrësi i siguron Organizatorit të Konkursit nuk do të ndahen ose zbulohen për asnjë palë të tretë.

Organizatori do të përpunojë dhe mbajë të gjitha të dhënat në përputhje me legjislacionin përkatës dhe aktet e tij të brendshme.

Në rast se pjesëmarrësi dëshiron të kundërshtojë përpunimin, qasjen, transferimin, fshirjen ose shfrytëzimin e të drejtave të tjera që kanë të bëjnë me të dhënat personale, pjesëmarrësi mund të kontaktojë Organizatorin përmes info@dormeo-ks.com ose 038 244 644 91.

Të dhënat personale do të përpunohen gjatë konkursit dhe për 365 ditë pas përfundimit të konkursit. Pas skadimit të kësaj periudhe, të gjitha të dhënat personale do të fshihen ose do të mbeten anonime.

Përjashtim bënë:

- Nëse një pjesëmarrës ka dhënë pëlqimin për marketing të personalizuar (pëlqim i veçantë, i cili nuk kërkohet për pjesëmarrje në Konkurs), të dhënat e tyre personale do të vazhdojnë të përpunohen në përputhje me Politikën e Privatësisë, që mund të gjendet në dormeo-ks.com/politika-e-ruajtjes-se-fshehtesise;
- Të dhënat personale të fituesit mund të përpunohen më gjatë, bazuar në kontratën midis organizatorit dhe fituesit.

Në rast se pjesëmarrësi dyshon për ndonjë shkelje të të dhënave personale, mund të kontaktojë Zyrtarin për Mbrojtjen e të Dhënave dhe mund të raportojë një shkelje të tillë të dyshuar tek Autoriteti Mbikëqyrës.

Përgjegjësia e organizatorit

Organizatori nuk mban përgjegjësi për ndonjë pasojë që mund t'i ndodhë pjesëmarrësit për shkak të pjesëmarrjes në konkurs.

Duke marrë pjesë në konkurs, pjesëmarrësit pranojnë të gjithë përgjegjësinë për dëmtimin, humbjen ose detyrimet indirekte ose të drejtpërdrejta që mund të ndodhin duke hyrë në konkurs dhe përdorimin e produktit.

Për më tepër, Organizatori nuk mban përgjegjësi për aplikime të paplota ose të pasakta. Në rast të ofrimit të informacionit të paplotë, pjesëmarrësi nuk ka të drejtë të marrë çmimin.

Organizatori rezervon të drejtën që, në rast të rrethanave të paparashikuara, në çdo kohë dhe pa njoftim paraprak të ndërpresë, pezulloj përkohësisht, riorganizohet dhe/ose në ndonjë mënyrë tjetër përfundon paraprakisht ose më vonë Konkursin.

Organizatori rezervon të drejtën për të ndryshuar Rregullat në mënyrë që të shmangët abuzimi i Konkursit në dëm të Pjesëmarrësve.

Prishtinë, 26.02.2019